

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Nr.Prot: PR - 0077

Data: 27.05.2024

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit..

I. Objekti i Fteses per Oferte

Banka ProCredit Shqiperi eshte e interesuar te kete bashkepunim me nje prej shoqerive lidhur me kerkesen e blerjes dhe mirembajtjes se pajisjeve elektrike per Zyren Qendrore.

(Ne permbajtje ne Aneksit nr.1 jane te gjitha detajet per pajisjet qe do te blihen per Zyrat e reja Qendrore me vendndodhje ne Tirane (ambjenti per te cilen eshte adresuar kerkesa per oferte).

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

1. Ftesa per oferte - 3 Faqe
2. Aneksi Nr. 1 - 3 Faqe
3. Aneksi Nr.2 - 1 Faqe
4. Letra Antikorrupsion - 1 Faqe
5. Formulari i Ofertes - 1 Faqe
6. Deklarate per gjendjen gjyqesore- 1 Faqe
7. Formulari ILO

II. Oferta

A. Oferta Teknike-Ligjore, e cila paraqet *Kriteret e Pranimit/Kualifikimit dhe* duhet te perpilohet sipas kerkesave te renditura me poshte:

1. Subjekti duhet te provoje qe eshte i rregjistruar ne rregjistrin tregtar dhe per kete duhet te paraqese nje kopje te Ekstraktit Historik, te leshuar nga **Qendra Kombetare e Biznesit**.
2. Subjekti duhet te paraqes nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka plotesuar dhe shlyer detyrimet tatimore, leshuar nga **Administrata Tatimore**.
3. Subjekti duhet te paraqes nje dokument qe vërteton se janë paguar kontributet per sigurimet shoqerore, lëshuar nga Administrata Tatimore.
4. Subjekti duhet te paraqese nje deklarate nga perfaqesuesi i subjektit i cili deklaron qe subjekti nuk eshte ne proces falimentimi, nuk eshte denuar per shkelje penale, nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional (sipas formes bashkangjitur).

Shenim: Dokumentacioni i kerkuar ne Kriteret e Pranimit/Kualifikimi ne pikat nga 1, 2 dhe 3, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar jo me pare se tre muaj nga data e fundit e dorezimit te ofertes. Dokumentat e mesiperme mund te paraqiten origjinal/ te noterizuar ose kopje te dokumentave origjinale.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Ofertuesit te shpallur fitues do ti kerkohet ky dokumentacion ne origjinal ose te noterizuar.

Shoqeria qe do te shpallet fituese ne kete tender, duhet te hape nje numer llogarie ne banke (nese nuk ka). Kushtet per hapjen e llogarise bankare i gjeni ne faqen WEB te Bankes.

Dokumentacioni i profilit te subjektit dhe elemente te tjere teknik:

Subjekti juaj, duhet te provoje kryerjen/realizimin e sherbimeve te se njejtës natyre duke paraqitur:

- CV e detajuar e subjektit tuaj per aktivitetin qe nga data e themelimit bashke me nje strukture te shoqerise.
- Nje liste te institucioneve/subjekteve per te cilat keni realizuar furnizime/sherbime te ngjashme, te shoqeruara me numrat e kontaktit ose referencat perkatese
- Skeda e detajuar teknike per secilin produkt .
- Cilesia e gjeneratoreve dhe UPS duhet te jene sipas standarteve te cilesise se Komunitetit Europian (CE Mark), shoqeruar me dokument qe verteton kete standart cilesie.
- Nje kopje te dokumentit te garancise sipas kushteve perkatese si dhe percaktimi i afatit te garancise (nese eshte me shume se 2 vjet)
- Nje pershkrim te detajuar ne lidhje mirembajtjen e produkteve (sipas Aneksit nr.1) duke specifikuar me dokumentat /pershkrimet perkatese:
Kohen e reagimin (Sipas Aneksit nr.1)
Numri i stafit qe eshte pergjegjes per mirembajtjen e produkteve
Eksperienca e shoqerise ne mirembajtje duke e vertetuar me nje liste te institucioneve me kontakte/referenca/kopje kontratash.
- Kopje te certifikatave ISO nese dispononi

Kriter skualifikues

Afati i levrimit duhet te jete sipas kushteve te percaktuara ne Aneksin nr.1.

Informacione nga shoqeria:

Afati maksimal per montimin e te gjithë pajisjeve eshte: _____

Garancia per pajisjet e mesiperme eshte : _____

- B. **Oferta Ekonomike**, e cila duhet t'u permbahet kerkesave te **Aneksit Nr. 1** bashkangjitur kesaj ftese per oferte. Cmimet e ofruara duhet te perfshijne TVSH-ne. Monedha e kuotuar duhet te jete ne **Leke**. Ne rastet e ofertimit ne nje monedhe te ndryshme nga Leke, per reference do te merret kursi i kembimit te Bankes se Shqiperise ne daten e dorezimit te ofertave.

Letra Anti korrupsion: Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Letra Antikorrupsion e cila duhet te firmoset/vulohet nga subjekti juaj dhe te dergohet se bashku me **oferten tekniko-ligjore**.

Deklarata mbi gjendjen gjyqesore: Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Deklarata mbi Gjendjen Gjyqesore e cila duhet te firmoset/vulohet nga subjekti juaj dhe te dergohet se bashku me **oferten tekniko-ligjore**.

Formulari i Ofertes: Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Formulari i Ofertes i cili duhet te firmoset/vulohet nga subjekti juaj dhe te dergohet se bashku me **oferten ekonomike**.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

III. Dorezimi i Ofertes

Oferta juaj duhet te jete e ndare ne **dy zarfa te ndryshem**. Dokumentacioni ligjor dhe teknik duhet te jete ne nje zarf dhe oferta ekonomike ne nje zarf tjetër.

Te dyja keto zarfe te cilat duhet te shenojne qarte se cfare permbajne, **pra oferta ekonomike dhe oferta tekniko-ligjore**. Zarfat duhet te jete te vulosur nga subjekti ne pjesen e ngjitjes se tyre. Ata duhet te kete te shkruar qarte: **RFO-08-04-2024-Blerje Pajisje Elektrike per ProCredit Bank, Zyrat Qendrore dhe Emrin e Subjektit** qe e dergon. Zarfat duhet te protokollohen prane recepsionit te Zyrove Qendrore te PCB-se dhe Subjekti duhet te sigurohet qe kjo oferte eshte protokolluar. Per te shmangur cdo paqartesi, kerkojme qe perfaqesuesi i subjektit te mos largohet nga Zyrat Qendrore te PCB-se pa marre numrat e protokollit te ofertes. **Ne total duhet te jene dy numra protokolli.**

Ne rast se oferta juaj dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose ne ndonje menyre tjetër nga ajo e kerkuar me lart, oferta nuk do te konsiderohet e vlefshme.

Ofertat tuaja, ne zarfa te mbyllur dhe te vulosur, ne formatin e kerkuar do te adresohen dhe paraqiten ne:

Ref: RFO-08-04-2024- Blerje Pajisje Elektrike per ProCredit Bank, Zyrat Qendrore.

ProCredit Bank sh.a.
Rr. Dritan Hoxha
Laprake, Tirane

IV. Vleresimi i Ofertes

- Afati i fundit per dorezimin e ofertave ne Banke, ne adresen e mesiperme eshte date **07 Qershor 2024, ora 16:00**.
- Banka do te perzgjedhe si fitues subjektin i cili do te ofroje oferten me te pershtatshme per banken.

Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne:
info_procurement@procredit-group.com

Banka do te njoftoje me shkrim nese ju jeni fitues ose jo per procesin e tenderimit.

Per cdo sqarim/ankese ne lidhje me vendimin per procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni ne:
albankesaprokurime@procredit-group.com

Singerisht

ProCredit Bank sh.a



Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Aneksi nr.1 : Specifikime Teknike

A) Blerje GJENERATOR

Gjenerator 2 x 400 kVA, silencioz/supersilencioz me kuader automatike dhe paraleliteti. Ne kete ze duhet te përfshihet dhe projektimi i kuadrit te paralelitetit.

Specifikimet teknike per gjeneratorin

Nr.	Te dhena per Motor Gjeneratoret	Karakteristika Teknike	Fuqia ne KVA (Per tu plotesuar nga shoqeria)
1	Fuqia ne Stand-By	ESP	
2	Fuqia ne vazhdimesi	PRM	
3	Ftohja e motorit	Radiator uji	
4	Nr. Rrotullimeve	1500 rrot/min	
5	Lloji karburantit	Nafte	
6	Konsumi i karburantit me 25/50/75% ngarkese	Lit/h	
7	Tensioni	400 V, 3 F+ N	
8	Frekuenca	50 Hz	
9	Faktori i fuqise	0.8	
10	Paneli i komandimit	Automatik, dhe me mbrojtje nga mbingarkesat, mbi dhe nen tensioni, renditja e fazave, e vecuar nga gjeneratori me mundesi montimi ne objekt, perfshire te gjitha manovrat e automatikes	
11	Paneli i paralelitetit + projekt	Sipas projektit te propozuar nga shoqeria	
12	Centralina e panelit te komandimit	Me ekran digjital (perfshi te gjitha manovrat, te gjitha parametrat teknike, mbrojtje e saj) dhe me porte per lidhjen kabllore me interface	
13	Kabina e veshjes se motorrit te gjeneratorit	Super silencioze, me material special fonoizolues	
14	Niveli i zhurmave	dB (A) / 7m	
15	Alternatori	Me 4 pole , 3 F + N, me klase izolacioni-H, me vet ftohje, me mundesi regjistrimi per tensionin ne dalje ne kufijt +/- 0.5%, forma e valeve FHT<5%, permbajtja e formes harmonike te valeve <3%	
16	Periudha e garancise se komplet procesit te punes se gjeneratorit	Te pakten 2 VJET	
17	Çertifikata e cilesise	ISO 9001:2000	

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

B) Blerje UPS

UPS + Bateri + Bateribox fuqja: 80 kVA/cope, lidhja ne paralel

Nr.	Te dhena per UPS	Karakteristika Teknike	Fuqia ne KVA
			(Per tu plotesuar nga shoqeria)
1	Fuqia nominale	KVA	
2	Teknologji	On-Line, double conversion	
3	Teknologji	Walk-in power	
4	Tensioni ne hyrje	400V- 3F+N	
6	Tensioni ne dalje	400 V, 3F+ N	
7	Diapazoni i Tensionit ne hyrje	Min. $\pm 20\%$ me 100% ngarkese	
8	Diapazoni i Frekuences	$\pm 5\%$	
9	Frekuenca e punes	50 Hz	
10	Mundesi lidhje ne paralel	deri ne 4 UPS	
11	Shpejtesia e transferimit ne funksion normal	0 m/sek	
12	Eficensa e punes	$>96\%$	
13	Ftohja e paisjes	Me ventilator te brendshem	
14	Pjesa e komandimit	E inkorporuar ne pajisje, Analizues dixhital me shume funksione matje, celes per kalim By Pass, siguresa perkatese	
15	Kontrolli logjik	Nepermjet mikroprocesoreve,	
16	Sistemi i monitorimit	Lan Interface 3-faze hyrje, 3-faze dalje, parallel interconnection kit	
17	Çertifikimi	ISO 9001;2000; ISO 14001	
18	Bllok baterie per mbajtjen e ngarkeses	Me bateri 12v	
19	Autonomia e Ups ne ngarkese 75%	min	
20	Normativa	IEC 62040-3 (Voltage Frequency Indipendent) VFI-SS-111	
21	Periudha e garancise	Te pakten 2 vjet	

C) Blerje Bateri dhe Box

Eshte e nevojshme te dergohet oferte ekonomike per 3 llojet e baterive te meposhtme dhe me pas Banka do te vendose per cilin lloj do te vendose te blej.

- Bateri 12/40Ah
- Bateri 12/65Ah
- Bateri 12/80 Ah

Per boxin e baterive duhet te jepen permasat e box-it.

- **Shenime te rendesishme per blerjen e pajisjeve te mesiperme.** Afati i levrimt te pajisjeve duhet te jete brenda muajit Shtator 2024 dhe montimi duhet te perfundoje brenda muajit Tetor 2024. (nese do te kete ndryshime ne afat banka do te njoftoje ne cdo rast)
- Pajisjet nuk mund te vendosen ne objekt para shtator 2024 .
- Ne oferten teknike duhet te perfshihet dhe kohezgjatja e garancise ____ vjet dhe kushtet qe permban garancia. Garancia nuk mund te jete me e vogel se 2 vjet.
- Cilesia e gjeneratoreve dhe UPS duhet te jene sipas standarteve te cilesise se Komunitetit European.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

D) MIREMBAJTJA

Sherbimi periodik i gjeneratorit konsiston ne :

- Nderrim i filtrave te vajit, ajrit dhe naftes.
- Nderrimi i vajit.
- Kontroll vizual i gjendjes se pergjithshme te pajisjes.
- Kontroll vizual i gjendjes se motorrit.
- Kontroll vizual i gjendjes se alternatorit.
- Kontroll i gjendjes dhe i regjistrimit te rripave.
- Kontroll i serbatorit per rrjedhje.
- Kontroll i gjeneratorit me ngarkese.
- Kontroll i ujit ne radiator
- Kontroll i baterise dhe nivelit te elektrolitit.
- Kontroll i pastrimit te eterminalit te baterise.
- Kontrolli i rrjedhjes se tubave.
- Larje (pastrim i thelle) i gjeneratorit.

Sherbimi periodik i UPS konsiston ne :

- Kontroll i baterive.
- Kontroll i parametrave te tensionit te hyrjes dhe te daljes.
- Kontroll i skedes se karikimit.
- Kontroll i kondensatoreve.
- Kontroll i filtrave te tensionit.
- Kontroll i software-it.
- Pastrim i te gjithë komponenteve te UPS.
- Pastrim i te gjithë komponenteve te bllokut te baterise.
- Pastrim i freskueseve te UPS.
- Testim i te gjithë parametrave te UPS.

Sugjerojme qe sherbimi periodik per gjenerator dhe UPS te behet nje here ne vit, por presim konfirmimin/sugjerimin e shoqerise. Ne oferten teknike duhet specifikuar nese sherbimi periodik duhet te behet edhe gjate periudhes se garancise.

E) ASISTENCE TEKNIKE, RIPARIMI I DEFEKTEVE.

- Duhet te paraqitet nje liste çmimesh standarte per te gjitha pjeset e kembimit kryesore per gjenerator, UPS dhe bateri te cilat mund te jete e nevojshme te nderrohen gjate dhe pas perfundimit te periudhes se garancise.
- Duhet paraqitur nje tabele me kohen e reagimit per cdo kerkese per riparim si dhe kohen e reagimit per raste urgjente.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Aneksi Nr. 2: Oferta Ekonomike

Nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Çmimi per njesi ne ALL me TVSH blerje	Çmimi/sherbim/cope mirembajtje periodike
1	UPS + Bateri + Bateribox ¹ fuqia : 80 kVA/cope, lidhja ne paralel	cope	3		
2	Gjenerator 400 kVA, silencioz/supersilencioz me kuader automatike dhe paraleliteti ² Ne kete ze duhet te perfshihet dhe projektimi i kuadrit te paralelitetit	cope	2		
3	Kabllo e fuqise per lidhjen gjenerator/panel automatik – kuader kryesor i objektit	Total	1		n/a

¹Bateria duhet te sigurojne nje autonomi minimale 2 ore. Ngarkesa e UPS-ve nuk do ti kaloje 60% te fuqise totale te UPS-ve.
²Silencioz/supersilencioz me kuader paraleliteti,(duhen kuotuar te dy variantet silencioz dhe supersilencioz)

Shenim i rendesishem:

- Cmimet duhet te jene me TVSH te perfshire dhe duhet te permbajne te gjitha kostot e transportit deri ne banke.
- Ne cmimet e mesiperme duhet te perfshihet:
 - o Furnizimi i pajisjeve
 - o Transporti deri ne destinacion (godina e zyrave qendrore)
 - o Montimi i pajisjeve duke perfshire materialet e imta
- Banka ruan te drejten per ndryshimin e sasise apo anulimin e porosise para lidhjes se kontrates

Ne lidhje me sherbimin e mirembajtjes, ne oferten ekonomike duhet te perfshini zerat e meposhtem:

1. Cmimin sherbimit periodik sipas Aneksit te ofertes teknike.
2. Cmimin per pjeset e kembimit kryesore te pajisjeve ne rast defektesh si dhe hakun e punes (ore pune)

Per zerat e mesiperm ju lutem te specifikohet nese kostot aplikohen gjate apo pas periudhes se garancise.

Vendodhja e pikes se sherbimit per pajisjet e mesiperme jane Zyrrat Qendrore, Rr. Dritan Hoxha, Laprake, Tirane.

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Letra Antikorrupsion (Deklarata e Perputhshmerise)

Grupi ProCredit vlereson se ndikimet etike, shoqerore dhe mjedisore jane pjese e rrjetit te furnizimit. Vec kesaj, ndikimet pozitive mund te arrihen permes blerjes se produkteve dhe/ose sherbimeve me te pergjegjshme, si dhe duke punuar bashkerisht me furnitorët per te ndikuar pozitivisht ne performancën etike, shoqerore dhe mjedisore. Ndaj, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve/kontraktoreve te tij qe t'i permbahen nje pakete standardesh minimale per te garantuar pajtueshmerine e angazhimeve te tyre per çeshtjet kryesore shoqerore, mjedisore dhe te administrimit me standardet e larta te ProCredit.

Njesoj siç veprohet me klientet, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve dhe kontraktoreve te tij qe te mos angazhohen ne asnje prej veprimtarive te renditura ne Listen e Perjashtimit te ProCredit. Aktivitetet me te rendesishme, por jo te vetmet, qe permban kjo liste jane:

-Prodhimi ose veprimtarite qe perfshijne forma te demshme ose shfrytezuese te punes se detyruar/punes se demshme per femijet, praktikat diskriminuese ose praktikat qe i pengojne punonjesit te ushtrojne ne menyre te ligjshme te drejtat e tyre te lirise se organizimit dhe te negocimit kolektiv (per hollesi te metejshe, shihni piken a) te Listes se Perjashtimit)

-Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombetare, si dhe konventave dhe marreveshjeve nderkombetare per prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti apo veprimtarie (per hollesi te metejshe, shihni piken e) te Listes se Perjashtimit)

-Shoqeria konfirmon se nuk kryen aktivitate tregtare te gjendura ne listen perjashtimore te ProCredit Grup.

-Duke qene se Grupi ProCredit i permbahet Deklarates Universale per te Drejtat e Njeriut (1948) pret qe te njejten gje te bejne edhe furnitorët dhe kontraktoret e tij. Keshtu, shoqeria tregtare konfirmon se iu permbahet standarteve dhe etikes me te larte te biznesit gjate procesit te tenderit dhe gjate zbatimit te kontrates. Ajo zbaton standartet e Shendetit, Sigurise ne pune, Sigurise Mjedisore dhe standartet e ILO dhe nuk eshte e perfshire ne punen e detyruar ose ne punen e paligjshme te femijeve. Gjithashtu shoqeria konfirmon se nuk eshte e perfshire ne praktika diskriminuese apo praktika qe ndalojne punemarresit e saj per te ushtruar te drejten e tyre ligjore per t'u mbledhur dhe anetaresuar ne organizatat e punemarresve.

-Shoqeria pranon se perfshirja e saj ne nje nga praktikat e paligjshme te permendura me siper, do te sjelle perjashtimin e saj nga procedura e tenderimit ose nderprerjen e kontrates ne menyre te menjehershme nga ana e ProCredit Bank sha.

- Siç percaktohet ne Kodin e Sjelljes, Grupi ProCredit nuk toleron rastet e pastrimit te parave, mitmarrjes dhe korrupsionit. Prandaj, marredheniet e biznesit nuk mund te krijohen ose te vazhdohen ne rast se mesohet qe nje furnitor potencial eshte i perfshire ne rastet e pastrimit te parave, korrupsionit dhe/ose mashtrimit. Theksohet se Grupi ProCredit nuk pranon ryshfete te asnje forme dhe as nuk pranon angazhimin e furnitoreve ne praktika te tilla.

Furnitorët dhe kontraktoret qe rezultojne te perfshire ne veprimtari te kesaj natyre, do te perjashtohen nga mundesia per t'u bere partnere.

-ProCredit Bank do te refuzoje ofertat pjesemarrese ne tender, nese deshmohej ose nese konsiderohet se shoqeria eshte e perfshire ne ndonje rast te pastrimit te parave, mashtrimit ose ne raste korrupsioni gjate procesit te tenderit ose do te anuloi kontraten nese deshmohej se ka ndodhur ndonje nga keto raste gjate procesit te dhenies se kontrates.

-Per qellimet e kesaj politike aktivitetet e meposhtme do te konsiderohen si korrupsion:

- a) Veprimin e te dhenit, pranuarit ose kerkimit te mjeteve te çfaredo vlere, per te ndikuar te ndonje person tjeter juridik, personel te PCB-se ose te ndonje shoqeri tjeter, gjate procesit te tenderimit ose gjate dhenies se kontrates.*
- b) Dëmtimin e prones se PCB-se, kercenimin e personelit te PCB-se, kercenimin per demtim te reputacionit te PCB-se ose ndonje shoqerie tjeter per te ndikuar ne procesin e tenderimit ose per zbatimin e kontrates se dhene.*
- c) Marreveshjen ne mes te dy ose me shume shoqerive per te imponuar ose per te ndikuar ne tenderet e papershtatshem, tendere me çmime artificiale ose çmime jo konkurruese.*

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

d) Falsifikimin e qellimshem, ndryshimin, fshehjen ose paraqitjen e gabuar te informatave te kerkuara ose te paraqitura gjate procesit te tenderit ose gjate zbatimit te kontrates.

-Per qellimet e kesaj politike veprime te mashtrimit konsiderohen perpjekjet ose pakujdesite e qellimshme per te mashtruar ose perpjekjet per te mashtruar stafin e PCB-se ose shoqerive te tjera, ne menyre indirekte ose te drejtperdrejte, per te perfituar financiarisht ose per t'ju shmangur detyrimeve te percaktuara me kontrate ose me ligj.

Grupi ProCredit pret prej furnitoreve te tij te angazhohen dhe te respektojne ndershterisht standardet e percaktuara ne kete dokument. Furnitoret priten te demonstrojne angazhimin e tyre duke bashkepunuar ngushtesisht me Grupin ProCredit, si dhe duke ofruar akses te arsyeshem ne dokumentacionin/informacionin perkates, nese gjykohet e nevojshme. Ne rastin e shkeljeve te renda dhe/ose te vazhdueshme te standardeve te percaktuara ne kete dokument, Grupi ProCredit do te ndermarre hapat e nevojshem per nderprerjen e marredhenieve te biznesit.

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruessit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkruar ne emer te furnitorit dhe per t'u angazhuar per respektimin e standardeve te percaktuara ne te.

Deklarata per t'u nenshkruar nga furnitori/kontraktori

Emri i kompanise _____

Numri i regjistrimit _____

Numri i kontrates/tenderit _____

Adresa _____

Data _____

Nenshkrimi i autorizuar _____

Emri _____

Titulli _____

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet te plotesoje kete Formular ne perputhje me udhezimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zevendesim te ketij formati.]

Date: ____/____/____

[plotesoni daten (dite, muaj, vit) e dorezimit te ofertes]

Numri i fteses :.....:

Per: **ProCredit Bank**
Departamenti Mbeshtetjes se Biznesit dhe Kanaleve Digjitale
Tirane, Shqiperi

Ne, te nenshkruarit, deklarojme qe:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe pranojme, pa rezerva ose perjashtime, kerkesat, afatet dhe kushtet e shprehura ne to;
- (b) Ne sigurojme furnizimin ne perputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levrimet per Mallrat dhe Sherbimet respektive si me poshte
_____ [plotesoni shkurtimisht mallrat, apo sherbimet respektive];
- (c) Ne permbushim gjithë kerkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike te specifikuara ne dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorezuara me kete deklarate.
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, perfshire cdo detyrim tatimor eshte: _____ [plotesoni cmimin total te ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhen];
- (e) Oferta jone do te jete e vlefshme nga data e dorezimit te ofertes deri me date.....;
- (f) Nese oferta jone do te pranohet, ne angazhohemi te mbajme nje garanci kontrate ne perputhje me dokumentat e tenderit nese kjo eshte e aplikueshme;
- (g) Ne nuk kemi konflikt interesi ne perputhje me Letren Antikorrupsion;
- (k) Ne kuptojme se kjo oferte, sebashku me njoftimin tuaj zyrtar te shpalljes se fituesit do te sherbeje si nje kontrate e perkohshme ndermjet nesh, derisa te pergatitet dhe nenshkruhet kontrata zyrtare.
- (l) Ne kuptojme qe nuk jeni te detyruar te pranoni oferten me cmimin me te ulet ose cdo oferte tjeter qe ju mund te merrni.

Firmosur: _____

Date: _____

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E shoqerise pjesemarrese ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date _____ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt _____

Une i nenshkruari _____ me cilesine _____ te shoqerise _____ deklaroj se:

- Shoqeria _____ nuk eshte denuar per shkelje penale,
- Shoqeria _____ nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqeria _____ nuk eshte ne proces falimentimi

Data e dorezimit te deklarates _____

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

Pyetesi ILO

Pyetesi i ILO-s per perputhshmerine e furnitoreve

1. Informacione te pergjithshme

Emri i kompanise	
Produktet kryesore dhe sektori	
Shteti/shtetet e prodhimit/operimit	
A i eksportoni/ofroni produktet/sherbimet tuaja ne vendet e BE-se?	

2. Shendetit dhe siguria profesionale

A ka vendosur dhe a zbaton kompania juaj procedura per shendetin dhe sigurine profesionale ne perputhje me praktiket e mira nderkombetare te industrise per te parandaluar aksidentet, demtimet dhe semundjet? A mund te rendisni disa nga udhezimet/standartet dhe procedurat perkatese? Sa shpesh rishikohen apo monitorohen ato?	
A ka kualifikime/trajtime specifike qe duhet te kete stafi juaj per te kryer detyra te caktuara? Si i ndiqni nevojat per trajnim? Nje here ne sa kohe zhvillohen trajnime?	
Si e ndiqni dhe si e raportoni shkallen e demtimeve, semundjeve profesionale, ditet e mungesave, fenomenin e te munguarit ne pune dhe numrin e viktimave qe lidhet me punen?	
Si i parandaloni zjarret dhe çfare do te benit ju dhe stafi juaj ne rast emergjence per shkak te nje zjarri?	
Nese pyetja vlen per kompanine ne fjale: A e pajisni stafin me pajisje mbrojtese? Nese po, çfare pajisjesh?	

3. Barazia ne mundesi dhe ne trajtim

Si e ndiqni diversitetin ne kompanine tuaj?	
Si e parandaloni diskriminimin ne kontekstin e rekrutimit, shperblimit dhe ngritjes ne detyre? A keni mekanizma per shqyrtimin e ankesave?	
A aplikoni mekanizma/politika/programe specifike per te inkurajuar grate apo grupet e tjera vulnerabel? Per shembull, ketu mund te perfshihen targetet lidhur me raportin specifik femra-meshkuj, programe mentorimi te projektuara specifikisht, si	

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

dhe koncepte specifike per komunikimin me grupet vulnerabel.	
--	--

a. Dokumentacion shtese

Ju lutemi, ndihuni te lire t'i bashkengjitni pergjigjes suaj per pyetjet e mesiperme dokumentet perkatese (pra, procedura, udhezime, politika dhe standarde, nese deshironi).

b. Konfirmimi

Data dhe vendi

Emri i plote dhe pozicioni

Firma

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne se kane autoritetin te nenshkruajne ne emer te kompanise dhe te japin pergjigje plotesisht te verteta.